

METAMORFOZA E UNIVERSITETEVE SHQIPTARE

RAPORT MONITORIMI

Shtator 2023



AUTOR
GEVIO TABAKU

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qg.com.al

Metamorfoza e Universiteteve

Procesi i aplikimit në IAL (Institucionet e Arsimit të Lartë) së bashku me datat përkatëse specifikohen në Urdhrin nr. 10, dt. 10/07/2023¹, të lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH). Ndryshimi kryesor nga viti i kaluar është se tashme kandidatët do të konkurojnë vetëm në dy runde aplikimi në vend të tre. Megjithatë, kandidatët do të kenë mundësi që të regjistrohen në një program studimi në IAL pavarësisht aplikimit në portalin e aplikimit universitar UAlbania, për një periudhë 6 ditore pas përfundimit të raundit të dytë.

Për të aplikuar në procesin e maturës shtetërore në mënyrë që të finalizojnë ciklin e shkollës së mesme, nxënësit e klasave të 12 (maturantë) do duhet që të plotësojnë paraprakisht formularin A1. Ky formular është detyrim edhe për aplikimin universitar, pasi pa të maturantët nuk mund të vijojnë me këto procese. Gjatë këtij viti, formulari A1 është plotësuar nga rreth 27 260 maturantë, të cilët gjatë plotësimit të tij kanë opsionin e shprehjes se interesit për të studiuar jashtë vendit². Ky opsion është zgjedhur nga rreth 39.8% e të gjithë maturantëve të këtij viti, çka shpreh dëshirën e një pjesë të madhe të tyre për t'u larguar nga vendi.

Në Shqipëri, ka 13 institucione të arsimit të lartë (IAL) publike dhe 26 IAL private. Këto institucione ofrojnë një total prej rreth 32,700 vendesh studimi në 653 programe të ndryshme.

Për krahasim, numri i aplikantëve për vitin akademik 2023 ka shënuar një ulje prej 6.6% në krahasim me vitin e kaluar. Konkretisht, kemi pasur 19 612 aplikantë në vitin 2023, ndërsa rreth 21 000 aplikantë në vitin 2022. Megjithatë, IAL-të kanë shënuar një rritje në disponibilitet. Numri i programeve të studimit është rritur me 15.1% krahasuar me vitin 2022, duke shkuar nga 555 programe studimi në 2022 në 653 për vitin akademik 2023. Po ashtu, numri i vendeve të studimit është shtuar me 2.2%, duke arritur në 32 700 kuota për vitin 2023, në krahasim me

30 007 kuota të ofruara në vitin 2022.

Ndryshimet në mënyrën e funksionimit të programeve të studimit që konsiderohen prioritet kombëtar

Në muajin Qershor të vitit 2022, Ministria e Arsimit dhe Sportit erdhi me vendimin **nr. 386 dt. 1.6.2022**, "Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të

¹ https://ualbania.al/theme/files/urdher_i_perbashket_rash_qsha_nr_10_2023.pdf

² <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/01/Formulari-A1.pdf>, pika 7.

studentëve të shkëlqyer e të studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet Publike të Arsimit të Lartë³. Ky vendim i mundëson studentëve të cilët plotësonin kriteret e caktuara përfitimin e një burse mujore në vlerën e pagës minimale si edhe përjashtim nga tarifa vjetore e studimit, mjafton që ata të regjistroheshin në një program studimi që përbënte prioritet kombëtar.

Sipas vendimit origjinal, bursen e përfitonin të gjithë studentët që:

1. Nuk janë përfitues të ndonjë financimi tjetër nga shteti shqiptar.
2. Plotësojnë një nga kriteret e mëposhtme:
 - a. Kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare 10.00 dhe në secilin prej provimeve kombëtare të detyruara të maturës shtetërore është vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 9.5 deri në 10.00;
 - b. Studenti fitues i njërit prej tri çmimeve të para në olimpiadat ndërkombëtare të arsimit parauniversitar, me më shumë se 15 vende pjesëmarrëse, pavarësisht notës mesatare, kur pranohet në programe studimi, që lidhen me lëndën/t/disiplinën ku ka fituar çmimin;
 - c. Studenti, i cili ka zgjedhur të ndjekë një prej programeve të studimit, që përbën prioritet kombëtar dhe që ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare, jo më pak se 8.5, përfshirë notën e përshkallëzuar të provimeve kombëtare të detyruara të maturës shtetërore;

Në datë **29.6.2023** vendimi është ndryshuar nëpërmjet **VKM-së nr. 3974**, duke sjellë disa ndryshime rrënjësore për studentët përfitues të bursës:

1. U hoq kriteri i notës mesatare për të gjithë studentët që zgjedhin të studiojnë në një program studimi që konsiderohet prioritet kombëtar. Të gjithë studentët që gëzojnë një mesatare të kombinuar të shkollës së mesme dhe provimeve të maturës mbi 6.5 kanë mundësi të përfitojnë bursën.
2. Për të vazhduar me marrjen e bursës edhe në vitet akademike pas të parit, studentët duhet të ruajnë një mesatare jo më pak se 9.5.
3. Jo të gjithë studentët që plotësojnë kriteret dhe aplikojnë për bursën e programeve prioritare do e përfitojnë atë (ndryshe nga viti 2022, ku çdo aplikant me mesatare mbi 8.5 ishte automatikisht edhe përfitues i bursës). Sipas pikës 6/1 në vendimin e përditësuar, universitetet me anë të një vendimi të senatit akademik duhet të alokojnë kuota për përfitimin e bursës në proporcion me numrin e studentëve të regjistruar në atë program studimi. Në rast se numri i aplikantëve për bursë është më i madh se numri i kuotave të alokuara, aplikantët renditen në bazë të mesatares së tyre në pranim.

³ <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/06/01/386/2b481639-f529-4d28-be00-217d991371b6>

⁴ <https://qbz.gov.al/preview/8206de24-a19d-4956-bdc6-63bb5575d410/cons/20230724>

Edhe lista e programeve të studimit që konsiderohen prioritet kombëtar ka ndryshuar⁵, duke përfshirë tashmë edhe programe studimi të tilla si arsim parashkollor, arsim fillor, histori-gjeografi, inxhinieri fizike, etj.⁶.

Programet e studimit që rrezikojnë të mbyllen si edhe programet e studimit prioritare⁷

Vështrim i përgjithshëm

Universiteti	Programe studimi	Rrezikojnë të mbyllen	Prioritare në total	Prioritare që rrezikojnë të mbyllen
Universiteti i Tiranës	38	10 (26.3%)	7	2 (28.5%)
Universiteti Politeknik i Tiranës	25	6 (24%)	6	3 (50%)
Universiteti Bujqësor i Tiranës	33	5 (15.1%)	15	4 (26.6%)
Universiteti i Durrësit	51	11 (21.5%)	7	2 (28.5%)
Universiteti i Elbasanit	45	21 (46.6%)	8	4 (50%)
Universiteti i Vlorës	32	12 (37.5%)	9	7 (77.7%)
Universiteti i Korçës	32	10 (31.2%)	10	2 (20%)
Universiteti i Shkodrës	30	10 (33.3%)	9	5 (55.5%)
Universiteti i Gjirokastrës	22	9 (40.9%)	9	4 (44.4%)
Total	308	94 (30.5%)	80	33 (41.2%)

30.5% e programeve të studimit në nëntë universitetet kryesore të vendit rrezikojnë të mbyllen. Universiteti i Elbasanit mban vendin e parë me 46.6% të programeve të cilat kanë më pak se 10 studentë të regjistruar. Ky universitet ka gjithashtu një numër prej 11 programesh studimi të cilat kanë 0 regjistrime, pra mund të konsiderohen programe studimi të mbyllura.

Paçka se studentëve të regjistruar në programet e studimit që konsiderohen prioritet kombëtar u është ofruar një bursë e barasvlefshme me pagën

⁵ Për listën e programeve të studimit që konsiderohen prioritare sipas vendimit të vitit 2022, shiko shtojcën nr. 1 [këtu](#).

⁶ Për listën e plotë të programeve të studimit që konsiderohen prioritare sipas vendimit të përditësuar të vitit 2023, shiko shtojcën nr. 1, bashkëngjitur këtij studimi.

⁷ Të dhëna të marra në portalin e aplikimit universitar "UAlbania" pas përfundimit të rundit të dytë të aplikimeve universitare.

minimale, ata përsëri nuk i preferojnë këto programe pasi më shumë se 41.2% e tyre rrezikojnë të mbyllen. Megjithatë, regjistrimet në programet e studimit prioritare kanë një përmirësim të ndjeshëm në krahasim me vitin 2022, ku rreth 71.6%⁸ e këtyre programeve rrezikonin të mbylleshin. Studentët nuk i preferojnë programet prioritare të studimit sepse në shumicën e tyre tregu i punës nuk ofron siguri.

Universiteti i Tiranës

Programi i studimit	Kuota fillestare	Kuota të mbetura	Regjistrime	Degë prioritare?
Kimi	60	54	6	Po
Kimi Industriale dhe Mjedisore	70	61	9	-
Fizikë	50	42	8	Po
Gjuhë Turke	60	53	7	-
Gjuhë Spanjolle	60	56	4	-
Gjuhë Angleze (Sarandë)	45	40	5	-
Filozofi	70	66	4	-
Gjuhë Greke	20	20	0	-
Përkthim dhe Interpretim në Gjuhën Greke dhe Angleze	30	25	5	-
Gjuhë Ruse	25	25	7	-

Universiteti Politeknik i Tiranës

Programi i studimit	Kuota fillestare	Kuota të mbetura	Regjistrime	Degë prioritare?
Inxhinieri Gjeomjedis	50	43	7	Po
Inxhinieri Fizike	40	37	3	Po
Inxhinieri Matematike	60	53	7	Po
Inxhinieri Gjeologjike	50	46	4	-
Inxhinieri e Burimeve Minerare	50	46	4	-
Inxhinieri Kimike	30	22	8	-

⁸ <https://qeverisja.qq.com.al/wp-content/uploads/2022/11/Pikiata-e-universiteteve.pdf>

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës

Programi i studimit	Kuota fillestare	Kuota të mbetura	Regjistrime	Degë prioritare?
Turizëm	25	17	8	Po
Informatikë Praktike	20	14	6	-
Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik me diplomë të dyfishtë të Universitetit "Aleksander Moisiu", Durrës me Universitetin La Sapiences , Romë	37	29	8	-
Menaxhim i Bankave	17	14	3	-
Menaxhim Hoteleri Turizëm	17	11	6	Po
Menaxhim i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme	17	14	3	-
Filozofi - Sociologji	10	6	4	-
Mekanik Impiante Industriale dhe Bujqësore	18	16	2	-
Mekanik Detare	18	17	1	-
Guidë Turistike	25	18	7	-
Gerontologji	15	7	8	-

Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër

Programi i studimit	Kuota fillestare	Kuota të mbetura	Regjistrime	Degë prioritare?
Gjuhë - Letërsi	35	29	6	Po
Gazetari dhe Komunikim	35	31	4	-
Pedagogji muzikore	30	24	6	-
Gjeografi	35	29	6	Po
Matematikë	30	23	7	Po
Fizikë	20	17	3	Po
Gjuhë Italiane	20	14	6	-
Gjuhë Gjermane	20	16	4	-

Gjeografi dhe Zhvillim Territori	30	28	2	-
Histori	40	39	1	Po

Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan

Programi i studimit	Kuota fillestare	Kuota të mbetura	Regjistrime	Degë prioritare?
Histori dhe Gjuhë Gjermane	10	10	0	-
Gjuhe shqipe dhe Rome	10	10	0	-
Gjeografi dhe Gjuhë Italiane	15	15	0	-
Gazetari dhe Gjuhë Angleze	15	15	0	-
Gjuhë Shqipe dhe Frënge	10	10	0	-
Gjuhë Italiane	10	10	0	-
Gjuhë Gjermane	10	10	0	-
Gjuhë Frënge	10	10	0	-
Fizikë Kompjuterike	10	10	0	-
Filozofi-Sociologji	10	10	0	-
Matematikë - Informatike	10	10	0	-
Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	20	11	9	Po
Gazetari	20	17	3	-
Biologji - Kimi	25	20	5	Po
Matematikë - Fizikë	25	20	5	Po
Logopedi	40	34	6	-
Psikologji	35	27	8	-
Ekonomia dhe e Drejta	40	35	5	-
Administrim Biznesi dhe Inxhinieri	25	22	3	-
Operator Turistik ne Gjuhe Gjermane	30	23	7	-
Operator Turistik	30	23	7	-
Studime Mjedisore	25	21	4	Po

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë

Programi i studimit	Kuota fillestare	Kuota të mbetura	Regjistrime	Degë prioritare?
Gjuhë Italiane	10	10	0	-
Gjuhesi e aplikuar ne fushen e Turizmit	20	20	0	-
Kimi	15	15	0	Po
Inxhinieri Navale	25	23	2	Po
Navigacion	25	21	4	-
Matematikë	25	24	1	Po
Gjuhë Shqipe Letërsi	24	21	3	Po
Mësuesi për Arsimin Fillor	25	19	6	Po
Pedagogji e Specializuar	30	23	7	-
Histori Gjeografi	20	17	3	Po
Matematike fizike	17	16	1	Po
Media komunikim dhe trashëgimi kulturore me profile 'Gazetari dhe Multimedia' dhe 'Trashëgimi kulturore'	25	18	7	-

Universiteti "Fan S. Noli", Korçë

Programi i studimit	Kuota fillestare	Kuota të mbetura	Regjistrime	Degë prioritare?
Gjuhë dhe Kulturë Frengje	20	18	2	-
Matematikë Fizikë	20	18	2	Po
Matematikë Informatikë	20	18	2	-
Teknika të Prodhimit të Farave dhe Fidanëve	25	19	6	-
Informatike Biznesi	30	21	9	-
Mbështetës Zyre për Komunikim Bibliotekë dhe Arkiv	20	14	6	-
Gjuhë Letërsi	20	12	8	Po

Gjuhe-Letersi Shqipe dhe Gjuhe pakicash	18	15	3	-
Filozofi Sociologji	20	20	0	-
Ekonomiks	25	25	0	-

Universiteti "Eqerem Çabej", Gjirokastër

Programi i studimit	Kuota fillestare	Kuota të mbetura	Regjistrime	Degë prioritare?
Histori dhe Gjuhë Italiane	15	15	0	-
Matematikë Informatike	15	15	0	-
Infermieri Mami	20	12	8	-
Histori Gjeografi	20	17	3	Po
Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	20	17	3	Po
Gjuhë Angleze	20	12	8	-
Mësuesi për Arsimin Fillor (kl. I-VI)	15	6	9	Po
Menaxhim i Turizmit të qendrueshëm	20	11	9	Po
Menaxhim Digjital	20	16	4	-

Universiteti Bujqësor i Tiranës

Programi i studimit	Kuota fillestare	Kuota të mbetura	Regjistrime	Degë prioritare?
Vreshtari - Enologji	-	-	0	Po
Bioteknologji Zooveterinare	30	30	0	-
Inxhinieri Pyjore- -Menaxhim i zonave të mbrojtura dhe parqe urbane	25	17	8	Po
Inxhinieri Agrare profili: Agromekanizëm	40	33	7	Po
Agrobiologji	30	28	2	Po

Universitetet e rretheve si fabrika infermierësh dhe diplomash profesionale

Regjistrimet në programet e studimit “Infermieri e përgjithshme & mami” në raport me totalin e regjistrimeve

Universiteti	Programi i studimit	Kuota	Regjistrime	Proporcioni i Regjistrimeve në Raport me Totalin (%)
Universiteti i Elbasanit	Infermieri e përgjithshme	250	247 (98.8%)	32.60%
	Infermieri Mami	160	114 (71.2%)	
Universiteti i Durrësit	Infermieri e përgjithshme	130	129 (99.2%)	12.29%
	Mami	52	51 (98%)	
Universiteti i Shkodrës	Infermieri e përgjithshme	100	100 (100%)	22.84%
	Infermieri (Mami)	60	60 (100%)	
	Infermieri (Fizioterapi)	50	44 (88%)	
Universiteti i Vlorës	Infermieri e përgjithshme	240	240 (100%)	41.19%
	Infermieri Mami	115	90 (78.2%)	
Universiteti i Korçës	Infermier i përgjithshëm	75	74 (98.6%)	18.91%
	Mami	30	27 (90%)	
Universiteti i Gjirokastrës	Infermieri e përgjithshme	70	69 (98.5%)	21.50%
	Infermieri Mami	20	8 (40%)	

Regjistrimet në programet e studimit profesionale të karakterit 2-vjeçar në raport me totalin e regjistrimeve

Universiteti	Programi i studimit	Kuota të vlefshme	Regjistrime	Proporcioni i Regjistrimeve në Raport me Totalin (%)
Universiteti i Durrësit	Guidë Turistike	25	7	25.81%
	Edukator për moshën 0-3 vjeçare	75	71	
	Gerontologji	15	8	
	Asistent Administrativ	30	16	
	Asistent Ligjor	30	19	
	Hidroteknikë Ujësjellës Kanalizime	30	14	
	Informatikë Praktike	20	6	
	Mekanik Detare	18	1	
	Mekanik Impiante Industriale dhe Bujqësore	18	2	
	Menaxhim Ndërtimi	30	18	
	Menaxhim Transporti Detar/Tokësor	40	35	
	Ndihmës Dentist	46	34	
	Specialist i Sistemeve të kondicionimit	26	11	
	Specialist Rrjetesh Kompjuterike	20	10	
	Teknik Elektrik	40	24	
Teknologji Automobilash	55	46		

	Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik	80	39	
	Specialist pajisjesh elektronike	80	17	
Universiteti i Shkodrës	Udhërrëfyes turistik dhe menaxhues i itinerareve turistike për rajonin verior	25	16	11.64%
	Pedagogji muzikore	30	6	
	Pikturë e grafikë	30	11	
	Specialist I larte elektrik	50	35	
	Teknik sistemesh dhe rrjetesh kompjuterike	50	36	
Universiteti i Elbasanit	Operator Turistik	30	7	22.40%
	Operator Turistik ne Gjuhe Gjermane	30	7	
	Sekretar I Specializuar dhe Administrativ	40	25	
	Edukator për fëmijët 0-3 vjeç	80	70	
	Logjistikë	37	11	
	Mekatronikë	50	32	
	Teknik Mjedis	77	65	
	Teknologji Laboratori	80	31	
Universiteti i Vlorës	Udherrefyesh Turistik per Rajonin e Jugut	60	16	10.11%
	Akuakulturë dhe higjenë e produkteve të peshkimit	51	20	
	Teknik Laboratori Kimik	52	45	

Universiteti i Korçës	Menaxhim Biznesi Bujqësor	25	13	22.47%
	Menaxhim Veterinar	25	10	
	Teknika të Prodhimit të Farave dhe Fidanëve	25	6	
	Edukim për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme	20	14	
	Mbështetës Zyre për Komunikim Bibliotekë dhe Arkiv	20	6	
	Asistent Menaxher	45	36	
	Shërbim Social	40	35	
Universiteti i Gjirokastrës	Asistent administrativ	31	24	35.57%
	Asistent Menaxher në Shërbimet Turistike	31	18	
	Ndihmës ekonomist	31	25	
	Edukatore për Zhvillimin e Fëmijërisë së Hershme 0-3 vjeç	50	49	
	Udhërrëfyes Turistik	30	11	

Universiteti	Regjistrime infirmieri/mami/programe profesionale	Proporcioni i Regjistrimeve në Raport me Totalin (%)
Universiteti i Durrësit	558	38.10%
Universiteti i Shkodrës	308	34.48%
Universiteti i Elbasanit	613	55.01%
Universiteti i Vlorës	411	51.30%
Universiteti i Korçës	221	41.38%
Universiteti i Gjirokastrës	204	57.13%

Të dhënat e mësipërme tregojnë realitetin e universiteteve të rretheve. Numri i regjistrimeve në programet e studimit 2-vjeçare me karakter profesional, si edhe në programet e studimit Infirmieri e përgjithshme dhe Mami në disa raste përbëjnë numrin më të lartë të të regjistruarve në këto universitete, të cilat gjenden në Durrës, Shkodër, Elbasan, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë.

Ky trend sjell disa shqetësime për sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri. Së pari, ai tregon një dëshirë të qartë të studentëve për të ndjekur programe profesionale, të cilat nuk janë të njohura gjerësisht në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe nuk janë të barabarta me një shkollim universitar të nivelit bachelor. Kjo mund të ndikojë në cilësinë e shkollimit dhe aftësitë e studentëve për t'u përshtatur në tregun e punës si brenda dhe jashtë vendit.

Së dyti, fenomeni i regjistrimeve të larta në programet Infirmieri e përgjithshme dhe mami sjell një sfidë të madhe për Shqipërinë: fenomenin "brain drain". Kreu i shoqatës së infermierëve, Elson Jaçaj, shprehet se gjatë periudhës 2020-2023 nga vendi janë larguar rreth 16 mijë infermierë⁹. Sipas analizës sonë, në përfundim të raundit të dytë të regjistrimeve janë ezauruar 99.1% e kuotave të lira në programin e studimit "Infirmieri e Përgjithshme" në gjithë universitetet publike të vendit. Pas diplomimit në këto programe, studentët janë të gatshëm të largohen nga vendi për të punuar në vendet tjera, duke krijuar një vakum të nevojshëm për shërbimet shëndetësore në vend.

⁹<https://tvklan.al/sfidat-e-infermiereve-ne-shqiperi-prej-2020-jane-larguar-rreth-16-mije-profesioniste-te-fushes/>

Rezultatet dhe ecuria e procesit të provimit të informatizuar të mjekësisë

Vështrim i përgjithshëm

Referuar vendimit **nr. 16, datë 05.02.2021**¹⁰ të Universitetit të Mjekësisë, i cili përcakton kriteret e pranimit për vitin akademik 2022-2023, përlogaritja e pikëve të kandidatëve të cilët konkurojnë për programet e studimit të ofruara në këtë universitet bëhej si vijon:

- 40% - Nota mesatare aritmetike e e provimeve të maturës shtetërore;
- 30% - Nota mesatare aritmetike e shkollës së mesme;
- 30% - Nota mesatare e lëndëve formuese (fizikë, kimi, biologji) të zhvilluara gjatë tri viteve të shkollës së mesme;

Vlerësimi total llogaritej tërësisht nga notat e marra gjatë viteve të shkollës së mesme dhe provimeve të maturës të cilat sipas raporteve periodike të Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA)¹¹ kanë rezultuar me nivel të ndjeshëm fiktiviteti.

Për të menaxhuar fiktivitetin e notave, por edhe për të rritur nivelin e meritokracisë, më 24 tetor, 2022, Universiteti i Mjekësisë i Tiranës së bashku me Qendrën e Shërbimeve Arsimore lidhën një marrëveshje bashkëpunimi¹² për të përfshirë një provim të informatizuar për të gjithë kandidatët e programit të studimit "Mjekësi e Përgjithshme". Ky provim përmban 30% të totalit të pikëve, ndërsa pjesa tjetër do të vijë nga notat e shkollës së mesme sipas ndarjes së mëparshme. Në komunikimet e znj. Evis Kushi, ish Ministre e Arsimit dhe Sportit, vihej në dukje angazhimi për të vendosur provimin e informatizuar në të gjitha programet e studimit të Universitetit të Mjekësisë dhe në të ardhmen edhe në universitetet e tjera të vendit.

Provimi i informatizuar u realizua në intervalin 14 - 23 gusht 2023 në ambientet e posaçme të QSHA të cilat kanë shërbyer më herët edhe për zhvillimin e provimeve të licensave të të diplomuarve në fushën e mjekësisë, psikologjisë, veterinarisë, por edhe të mësuesve.

¹⁰ <http://umed.edu.al/wp-content/uploads/2021/02/Vendim-Senati-Akademik-Nr.-16-date-05.02.2021.pdf>

¹¹ <https://qeversija.qq.com.al/wp-content/uploads/2023/07/matura-2.pdf>

¹² <http://umed.edu.al/wp-content/uploads/2022/02/Marr%C3%ABveshje-bashk%C3%ABpunimi-nd%C3%ABrmjet-MAS-dhe-UMT-p%C3%ABr-Testimin-e-informatizuar-p%C3%ABr-maturant%C3%ABt-n%C3%ABkuad%C3%ABr-t%C3%AB-pranimit-n%C3%AB-programin-Mjek%C3%ABsi-e-P%C3%ABrgjithshme.pdf>

Në krahasim me vitin 2022, numri i aplikantëve për programin e studimit "Mjekësi e përgjithshme" ra me gati 43% (3183 aplikantë në 2022, në rreth 1800 në 2023). Pas kryerjes së provimit të informatizuar dhe publikimit të renditjes së fituesve të raundit të parë të aplikimeve universitare së bashku me pikët e tyre¹³, numri total i aplikantëve zbriti në 1021, pasi rreth 800 prej tyre nuk kishin marrë pjesë në provimin e informatizuar.

Arsyeja kryesore që solli në rënien e aplikantëve në masën 67.9% në krahasim me një vit më parë është vendosja e ligjit **nr. 60, 2023, "Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë 'Mjekësi e përgjithshme' në institucionet publike të arsimit të lartë"**¹⁴, i cili detyron mjekët e rinj të punojnë në Shqipëri për së paku 5 vite pas diplomimit të tyre, si edhe vendosja e provimit të informatizuar.

Rënia drastike e numrit të aplikantëve ndikon drejt-për-drejt në cilësinë e mjekëve të ardhshëm pasi ¼ e aplikantëve e fitojnë automatikisht të drejtën e studimit duke qënë se kuotat e vlefshme të programit të studimit "Mjekësi e përgjithshme" ishin 400 për vitin akademik 2023-2024 dhe referuar deklaratave të ish-Ministres së Shëndetësisë, znj. Ogerta Manastirliu (tashme Ministre e Arsimit dhe Sportit), pritet të shkojnë në 500 gjatë vitit akademik 2024-2025¹⁵.

Efektet që solli vendosja e provimit të informatizuar

Programi i studimit "Mjekësi e Përgjithshme" është programi që ndër vite ka pasur konkurrencën më të madhe për të fituar të drejtën e studimit.

Në vitin 2022, programi "Mjekësi e përgjithshme" ofronte 360 kuota të disponueshme për aplikantët shqiptarë, dhe aplikanti i fundit i pranuar u rendit në pozicionin 486. Edhe pse 126 aplikantë nuk u regjistruan, duke i lënë vendin aplikantit të radhës në listë, mesatarja e kombinuar e nevojshme për të fituar ishte 9.78. Kjo mesatarje përfshinte një mesatare prej 10.00 gjatë viteve të shkollës së mesme dhe 9.55 në provimet e maturës shtetërore.

¹³ <http://umed.edu.al/wp-content/uploads/2023/08/Mjekesi-e-pergjithshme-Raundi-1-23-24.pdf>


¹⁴ <https://qbz.gov.al/share/ZKD5zOEKRLeofcRAdPVNBA>

¹⁵ <https://www.oranews.tv/politike/riten-kuotat-e-pranimet-ne-universitetin-e-mjekesise-500-kuota-per-vit-i1097041>

Viti akademik	Kuota të vlefshme	Renditja e fituesit të fundit	Mes. e shkollës së mesme	Mes. e provimeve të maturës	Mes. e kombinuar	Pikë provimi inf.
2023-2024	400	435	10,00	8,85	9,43	40/100
2022-2023	360	486	10,00	9,55	9,78	-

Pas vendosjes së provimit të informatizuar, mesatarja e kombinuar e nevojshme për të fituar u ul në 9,43 si pasojë e peshës prej 30% që kanë pikët e provimit. Vendosja e provimit uli ndjeshëm edhe numrin e aplikantëve që fitonin të drejtën e studimit por nuk regjistroheshin, duke ia lënë vendin aplikantit të ardhshëm në listë. Ky numër ndryshoi nga 126 aplikantë në vitin 2022, në vetëm 35 aplikantë në vitin 2023.

Rezultatet e aplikantëve në provimin e informatizuar



Referuar grafikut, pikët mesatare të marra nga 400 aplikantët e parë (fituesit) janë 60,7/100 pikë. Mesatarja e tyre e shkollës së mesme varion nga nota 9,6 - 9,85 te disa aplikantë, në 9,9-10,00 në shumicën prej tyre. Këto rezultate faktojnë fiktivitetin e notave, të paktën në sistemin arsimor parauniversitar.

Ka shumë arsye përse provimi i informatizuar është një nevojë e domosdoshme për të promovuar meritokracinë në sistemin tonë arsimor.

1. Provimi i informatizuar siguron një vlerësim objektiv të njohurive të aplikantëve. Rezultatet vijnë nga një kompjuter që aplikon kriteret e përcaktuara paraprakisht, larg ndikimeve subjektive që mund të ndodhin gjatë vlerësimit manual.
2. Provimi i informatizuar siguron që të gjithë aplikantët të jenë në kushte të barabarta. Nuk ka favorizim ose ndikim të jashtëm që mund të ndodhë në një vlerësim manual.
3. Provimet e informatizuara u mundësojnë aplikantëve të shohin pikët që ata kanë marrë në kohë reale fill pas përfundimit të provimit. Kjo kursen kohë dhe burime. Nuk ka nevojë për vlerësues që të korrigjojnë provimet një-nga-një, duke e bërë procesin efikas dhe më të volitshëm për sistemin arsimor.
4. Me provimin e informatizuar, fondi i pyetjeve dhe kriteret e vlerësimit janë transparente dhe të qarta për të gjithë. Ky nivel transparence ndihmon në garantimin e një procesi të besueshëm aplikimi dhe pranimit në universitet.
5. Provimi i informatizuar mund të testojë një numër të madh aplikantësh në një hapësirë të shkurtër kohore, duke evituar vonesat që vijnë nga proceset e ndryshme të administrimit të provimeve (për shembull vonesat e publikimit të notave të provimeve të maturës shtetërore ku në disa raste notat janë vonuar deri në 3 javë).

Për këto arsye, përdorimi i provimeve të informatizuara është një hap thelbësor drejt promovimit të meritokracisë në sistemin arsimor.

Gjetjet kryesore

- 39.8% e maturantëve të vitit shkollor 2022-2023 kanë deklaruar se do të studiojnë jashtë vendit gjatë plotësimit të formularit A1.
- Numri i aplikantëve ka shënuar një rënie me 6.6% në krahasim me vitin 2022 (19 612 aplikantë në vitin 2023, 21 000 aplikantë në vitin 2022).
- Numri i programeve të studimit është rritur me 15.1% në krahasim me vitin 2022 ndërsa numri i kuotave totale në të gjitha programet e studimit është rritur me 2.2%.
- Bursat që jepen për regjistrim në programet prioritare kanë ndryshuar duke bërë që përfitues të bursës të jenë vëtëm një pjesë e vogël e maturantëve të cilët duhet të ruajnë mesataren mbi 9.5 për të vijuar ta përfitojnë atë, në vitet e studimit pas të parit.
- 30.5% të programeve të studimit që ofrohen nga universitetet publike rrezikojnë të mbyllen pasi në to janë regjistruar më pak se 10 studentë. Ndërsa programet e studimit që konsiderohen prioritet kombëtar rrezikojnë të mbyllen në masën 41.2%.
- Në Universitetin e Elbasanit mbi 46.6% e programeve të studimit (21/45) rrezikojnë të mbyllen. Nga këto 11 programe studimi kanë 0 regjistrime.
- Shumica e studentëve në gjashtë universitetet publike të cilat ndodhen jashtë Tiranës janë regjistruar në programet e studimit Infermieri e përgjithshme ose Mami dhe në degë 2-vjeçare të karakterit profesional.
- Universiteti i Elbasanit, Universiteti i Vlorës, si edhe Universiteti i Gjirokastrës mbajnë numrin më të lartë të studentëve të regjistruar në programet e studimit Infermieri e përgjithshme ose Mami dhe në degë 2-vjeçare të karakterit profesional, ku më shumë se ½ e studentëve janë regjistruar në këto programe studimi.
- Në nivel kombëtar, në degën e studimit "Infermieri e Përgjithshme" janë ezauruar 99.1% të kuotave në universitetet publike, çka shpreh dëshirën e aplikantëve për ta përdorur këtë degë studimi si "pasaportë" për të emigruar nga vendi.
- Në krahasim me vitin 2022, numri i aplikantëve për programin e studimit "Mjekësi e përgjithshme" ra në masën 67.9% (3183 aplikantë në 2022, 1021 në 2023). Arsyeja kryesore është vendosja e ligjit i cili detyron mjekët e rinj të punojnë në Shqipëri për së paku 5 vite pas diplomimit të tyre.
- Mesatarja e kombinuar e nevojshme e shkollës së mesme dhe e provimeve të maturës shtetërore për të fituar të drejtën e studimit në mjekësi të përgjithshme është 9,43 (në krahasim me 9,78 në vitin 2022).
- Mesatarja e pikëve të marra në provimin e informatizuar të mjekësisë nga 400 fituesit është 60,7/100 pikë. Mesatarja e tyre e shkollës së mesme është 9,9.

Rekomandime

- Universitetet që gjenden jashtë qytetit të Tiranës duhet të profilizohen në mënyrë që të sigurohet një shpërndarje e balancuar e studentëve në gjithë vendin dhe të evitohen programet e studimit për të cilat interesi është i ulët.
- Për programet e studimit të cilat konsiderohen prioritet kombëtar duhet të kishte transparencë të shtuar për t'i vënë në dijeni studentët se jo të gjithë do mund të përfitojnë nga bursa. Gjithashtu, duhet të ishte vendosur një numër i paracaktuar kuotash të cilat do mund të përfitonin nga kjo bursë.
- Bursat e programeve të studimit që konsiderohen prioritet kombëtar nuk duhet të veprojnë vetëm si një mbështetje e përkohshme, por duhet të vijnë në formën e një paketë solide ku studentëve t'u garantohet punësimi pas diplomimit.
- Të shfuqizohet ligji **nr. 60, 2023, "Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë 'Mjekësi e përgjithshme' në institucionet publike të arsimit të lartë"**¹⁶ në mënyrë që të rriten aplikimet cilësore gjatë vitit të ardhshëm akademik (2024-2025).
- Të vendosen provime të informatizuara në programet e studimit ku interesi dhe konkurrenca e aplikantëve është me e lartë në mënyrë që procesi i konkurimit të jetë meritokratik.

¹⁶<https://qbz.gov.al/share/ZKD5zOEKRLeofcRApVNBA>

SHTOJCA NR. 1

Fushat e gjera të studimit	Fushat e detajuara të studimit	Programi i studimit		
Arsimi	Arsimi	Arsim parashkollor Arsim fillor		
Arte dhe humanizëm	Gjuhë dhe letërsi	Gjuhë shqipe dhe letërsi		
	Histori dhe arkeologji	Histori-Gjeografi		
Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë	Biologji	Biologji Biologji-Kimi		
	Biologji Shkencat e mjedisit	Studime mjedisore Shkenca mjedisore, profili: Menaxhim i burimeve natyrore		
	Shkencat e mjedisit			
	Kimi	Kimi		
	Fizikë	Fizikë		
	Matematikë	Matematikë Matematikë-Fizikë		
	Matematikë-Elektronikë dhe automatizëm	Inxhinieri matematike		
	Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim	Elektronikë dhe automatizëm Teknologjia e mbrojtjes së mjedisit	Inxhinieri fizike Inxhinieri mjedisi Inxhinieri navale	
Mjete motorike, anije dhe avionë		Navigacion dhe menaxhim detar		
Mjete motorike, anije dhe avionë		Inxhinieri e burimeve minerare		
Miniera dhe industri nxjerrëse		Inxhinieri e naftës dhe gazit		
Miniera dhe industri nxjerrëse Kultivim dhe prodhim			Inxhinieri gjeoinformatike Inxhinieri gjeologjike Inxhinieri gjeomjedis	
			Inxhinieri agrare, profil: mbrojtje bimësh Inxhinieri agrare, profil: hortikulture	
		Kultivim dhe prodhim Pyje		Inxhinieri agrare, profil: agronomi Inxhinieri agrare, profil: agromekanizëm Zootekni dhe siguria e produkteve blegtorale Biologji marine dhe akuakulturë Bioteknologji zooveterinare Agrobiologji Agrobiznes Agroushqim Vreshtari-Enologji Inxhinieri agronomike Inxhinieri pyjore Inxhinieri përpunim druri
				Mjekësi veterinare
Pyje	Menaxhim turizmi (rural, arkeologjik, kulturor, hotelieri-restorant, mikpritje)			
Veterinari				
Turizëm	Ekonomi-Turizëm			
Shërbime	Turizëm			

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al